- Kapacitet i fuqishëm kundër depërtimit të ujit.
- Lejon transpirimin e nënshtresës (i përshkueshëm nga avujt).
- Trajtimi është zakonisht i padukshëm dhe nuk ndryshon pamjen e nënshtresës
- Për shkak të reduktimit të absorbueshmërisë së ujit, përmirëson rezistencën e fasadave nga njolllosja dhe mbledhja e pislëqeve dhe ndihmon në reduktimin e rritjes së myshqeve dhe likeneve.
- Mund të mbivishet me bojëra dhe veshje të përshtatshme.
- Gati për përdorim.
- Me bazë uji dhe miqësor ndaj mjedisit

KONSUMIMI

- Mbi llaç: ~ 150-200 g/m²
- Mbi materiale të tjera poroze: ~ 300-500 g/m²

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
439327	lëng i bardhë	bidon 1 lt	480	1 kuti	copë
437370		bidon 5 lt	120		
437349		bidon 20 lt	30		



Sikagard®-700 S

Impregnim i padepërtueshëm nga uji me bazë siloksani



APLIKIMET

- Trajtim mbrojtës pa ngjyrë kundër depërtimit të ujit për materialet absorbuese të ekspozuara si betoni, suvatimet me bazë çimentoje, pllaka betoni, çimento me fibra, mure me tulla (argjil dhe rërë gëlqereje, të paqelqëzuara), gur natyror, etj.
- Prajmer hidrofob nën veshjet me bazë tretësi ose emulsionëve mbrojtëse
- Impregnim kundër depërtimit të ujit për nënsh-tresa absorbuese si betoni në struktura të inxhin-ierisë së ndërtimit ose në ndërtimin e strukturave prej betoni.

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Reduktim i absorbueshmërisë kapilare të ujit
- Redukton efloreshencën
- Redukton depërtimin e pisllekut në pore
- Përmirëson izolimin termik
- Mund të vishet me veshje me bazë tretësi dhe uji
- Qëndrueshmëri & rezistencë më e lartë se trajtimet tradicionale me bazë silikon
- Nuk ndryshon paraqitjen e nënshtrësës
- Redukton hyrjen dhe lëvizjen e joneve të klorurit
- Nuk vepron si pengesë avulli

KONSUMIMI

- 0.375–0.625 lt/m² (min. 2 veshje)

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
151824	lëng pa ngjyrë	kovë 5 lt	360	lt
151821		kovë 20 lt	480	

Sikagard®-790 All-in-One Protect

Mbrojtje e plotë për sipërfaqet vertikale dhe horizontale



APLIKIMET

- Mbrojtje e fasadave, dyshemeve dhe çative prej baze materiali mineral ndërtimi si:
- Gurë natyrorë: granit, gëlqere, mermer, etj.
 - Pllaka terrakota, tjegulla me bazë balte/ çimentoje
 - Beton, suvatim çimentoje, etj.



KONSUMIMI

- Nënshtrësja shumë poroze: 300 - 600 g/m²/veshje
- Nënshtrësja me pak porozitet: 50 - 200 g/m²/veshje

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Mbrojtje kundër depërtimit të ujit dhe vajit
- Mbrojtje kundër njollosjeve
- Përdorim mbi fasada, dysheme, çati
- I përshtatshëm për shumë nënshtrësja ndërtimi
- Lejon transpirimin e nënshtrësës
- Rezistencë ndaj UV
- Lehtëson pastrimin e grafiti
- Miqësor ndaj mjedisit

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
545998	lëng, e verdhë e lehtë	bidon 1 lt	10 copë	480	1 kuti	kg
545997		bidon 5 lt		450		



Video aplikimi



Sikagard®-790 All-in-One Protect

Sikagard®-905 W

Impregnim kundër kripës dhe lagështisë që ngurtësohet mbi sipërfaqe



APLIKIMET

- Mbrojtje nga lagështia dhe stabi-lizim i nënshtrësës
- Mbrojtje nga krijimi i kripës dhe mykut mbi sipërfaqe
- Mund të përdoret si forcues i sipërfaqes së nënshtrësave me pluhur dhe të dobëta

KONSUMIMI

- 0,2-0,3 l/m²/shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
95594	lëng i bardhë	bidon 2 lt	10 copë	360	1 kuti	lt

Sikagard®-907 W

Mbrojtës i sipërfaqeve poroze dhe stabilizues i rërës tek fugat





APLIKIMET

- Mbrojtje e dyshemeve me sipërfaqe poroze nga hyrja e ujit dhe vajit
- Stabilizim i rërës brenda fugave të dyshemeve me bloqe gurësh
- Sipërfaqe të shtruara me pllaka guri natyror ose artificial
- Dysheme betoni
- Rugë këmbësorësh, trotuare, tarraca, vende parkimi, etj.

KONSUMIMI

- Sipërfaqe të shtruara me pllaka dhe fuga me rërë: ~ 0,5-1,5 l/m²
- Sipërfaqe të tjera pa fuga: ~ 0,2-0,3 l/m²
- Konsumimi pakësohet, nëse kërkohet shtresë e dytë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
158935	lëng i bardhë	bidon 5 lt	4 copë	480	1 kuti	lt



Sikagard®-680 S Betoncolor

Bojë mbrojtëse për betonin



APLIKIMET

- Mbrojtje dhe përmirësim i betonit dhe materialeve të tjera prej çimentoje në ndërtesa dhe elemente infrastrukture.
- Shtresa transparente: pa ngjyrë, kur thahet merr pamje të shkëlqyeshme dhe është e përshtatshme si veshje rifreskuese
- Shtresa përfundimtare me ngjyrë: veshje përfundimtare e cila kur thahet kthehet mat, e disponueshme në shumë ngjyra

KONSUMIMI

- ~0,15-0,20kg/m²

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj konsumimit nga moti
- Për shkak të tharjes së shpejtë, veshja ka rezistencë ndaj shiut brenda një kohe të shkurtër
- Nuk ndryshon teksturën e sipërfaqes të betonit
- Mbron nga ndikimet agresive atmosferike, të cilat mund të depërtojnë tek betoni në formën e kripërave ose gazeve
- Rezistencë shumë e lartë ndaj difuzionit të dioksidit të karbonit, redukton shkallën dhe thellësinë e karbonimit të betonit

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
5769	lëng transparent	kovë 20 kg	420	kg
1440	lëng, RAL 9016	kovë 30 kg	630	

Sikagard®-681 Protection

Bojë mbrojtëse pa ngjyrë për betonin



APLIKIMET

- Sipërfaqe të jashtme betoni si: pllaka betoni me agregate të ekspozuara, blloqe-pllaka shtrimi, pllaka me motive dekorative
- Mbi tulla, gurë natyrorë dhe sipërfaqe të lëmuara
- Mbrojtje e estetikës së elementeve vertikale në ndërtesa, ndërtesa industriale, etj.

KONSUMIMI

- 0,10-0,15kg/m²/shtresë (0,12-0,17 lt/m²)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Finiturë estetike e lëmuar ose e shkëlqyeshme (varet nga lloji i nënshtresës)
- Mbrojtje betoni nga faktorët agresivë të mjedisit dhe karbonimi
- Rezistencë ndaj njollosjeve
- Pastrim dhe mirëmbajtje e lehtë
- Parandalon krijimin e algave
- Nuk zverdhet me kalimin e kohës
- Kompatibilitet me llaçet riparues Sika

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
160418	lëng transparent	kovë 3 lt	288	lt



Sikagard® Wallcoat N

Bojë epokside me 2 përbërës dhe me bazë uji



APLIKIMET

- Aplikim mbi beton dhe nënshtresa çimentoje
- Veshje izoluese me ngjyrë për sipërfaqe muri në mjedise të brendshme
- Në dhoma me higjienë të lartë
- Në mjedise prodhimi të industrisë ushqimore dhe pijeve, vende parkimi automjetesh, zona magazinimi dhe logjistike

KONSUMIMI

- ~ 0.28 kg/m² për shtresë

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Pa tretës
- Rezistencë e mirë kimike dhe mekanike
- I papërshkueshëm nga avujt e ujit
- Pastrohet lehtë
- Rezistencë e lartë ndaj karbonimit
- Vetë të shkëlqyera dekontaminimi
- Mbulim i mirë
- Pa erë
- Përzjerje dhe aplikim i lehtë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
		set A+B=20 kg		kg
155615	RAL 9003	A=14,6 kg	350,4	
104023		B=5,4 kg	648	

Sikagard® Poolcoat

Veshje me bazë uji për ekspozim nën ujë



APLIKIMET

- Veshje mbrojtëse për: rezervuare betoni të përforcuar
- Mbi sipërfaqe betoni, llaçesh çimentoje dhe gome të kloruar
- Në pishina me sistem pastrimi të ujit me bazë klori


KONSUMIMI

- ~ 0.15 kg/ m²/ shtresë

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj kalcifikimit dhe stabilitet ngjyre
- Rezistencë ndaj kremrave dhe vajrave kundër diellit
- Rezistencë ndaj ujit dhe kimikateve
- Mund të mbulojë veshjet ekzistuese prej gome të kloruar
- Pastrohet dhe dezinfektohet lehtë
- Shtim i kohës së mirëmbajtjes

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
76298	BLAU 32	kovë 10 lt	440	lt
76303	ADRIABLAU			
30412	e bardhë, RAL 9010			
45743	RAL 1013			



SikaColor®-500 W Primer

Prajmer akrilik i tretshëm në ujë për bojërat SikaColor®



APLIKIMET

■ Si prajmer për bojërat e fasadave SikaColor®

KONSUMIMI

■ 10-12 m²/lit

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Sipërfaqe të papërshkueshme nga uji
- Stabilizon nënshtresën dhe përmirëson ngjitjen e bojës
- Aplikim i lehtë, thahet shpejtë
- Nuk zverdh bojën përfundimtare
- Hollohet me ujë
- I transpirueshëm, përshkohet nga avujt e ujit
- Pa tretës, miqësor ndaj mjedisit
- Pa erë, i përshtatshëm për mjediset e brendshme

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
162631	lëng ngjyrë qumështi	bidon 5 lt	112	copë

SikaColor®-650 W

Veshje elastike me performancë të lartë, kundër ujit dhe me bazë akrilike për fasadat



APLIKIMET

- Veshje dhe izolim i sipërfaqeve të jashtme si: suvatimet, betoni, etj.
- Mbrojtje e fasadave kundër ujit, lagështisë, kripës në konstruksionet afër bregdetit

KONSUMIMI

■ 8-10 m²/lit

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Kundër ujit
- Mbyll plasaritjet
- I transpirueshëm
- Rezistencë ndaj UV, motit, vjetërimit
- Pa tretës, miqësor ndaj mjedisit
- Aplikim i lehtë
- Mbulim shumë i mirë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
159976	e bardhë	kovë 3 lt	60	copë
159975		kovë 10 lt	36	

SikaColor®-670 W

Bojë me bazë akrilike për fasadat e ndërtesave



APLIKIMET

■ Lyerje e sipërfaqeve të jashtme si suvatë, betoni, muret.

KONSUMIMI

■ 11-13 m²/lit (në varësi të nënshtresës)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- E përshkueshme nga avujt e ujit, lejon transpirimin e nënshtresës
- Rezistencë ndaj vjetërimit dhe konsumimit
- Pa tretës, miqësor ndaj mjedisit
- Rezistencë ndaj rrezatimit diellor
- Aplikim i lehtë
- Mbulim i mirë
- I përshtatshëm për përdorim të brendshëm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
159974	e bardhë	kovë 3 lt	60	copë
159973		kovë 10 lt	36	



Sikagard®-63 N

Veshje mbrojtëse epokside me 2 përbërës



APLIKIMET

- Shtresë mbrojtëse me rezistencë ndaj kimikateve mbi beton, gur, llaçe dhe suva çimentoje, çimento epokside, produkte me bazë rrëshire epokside, çelik
- Shtresë mbrojtëse për depozita magazinimi dhe silose
- Veshje kundër korrodimit mbi çelik në impiantet e përpunimit të ushqimeve, veprat e ujërave të zeza, ferma, ndërmarrje agrikulturore, mjedise kimike, farmaceutike, industria e pijeve

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Pa tretës
- Rezistencë e mirë mekanike dhe kimike
- Trashësi e madhe shtrese
- I papërshkueshëm nga lëngjet
- Përzierje dhe aplikim i lehtë

KONSUMIMI

■ ~ 0.15 kg/ m²/ shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
542782	RAL 7032	kovë A+B=10kg	300	kg

Sika® Poxitar F

Veshje kombinim epoksidi-vaji antraceni për aplikime të rënda mbi çelik dhe beton



APLIKIMET

- Veshje mbrojtëse për beton dhe çelik, për struktura të mbuluara me dhë, p.sh. sistemet e ujërave të ndotur, industria kimike, etj.
- I përshtatshëm kudo që aplikimi mbi beton të lagësht është i pashmangshëm.
- Nuk është i përshtatshëm për sipërfaqet në kontakt me ujin e pijshëm, mjedise me kafshë shtëpiake, stalla,etj.


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj sforcimeve të mëdha
- Rezistencë ndaj abrazionit & tronditjeve
- Rezistencë ndaj ujit dhe kimikateve
- Mund të ekspozohet ndaj ujit menjëherë pas aplikimit (*rekomandohet konsultimi me autoritetet për mbrojtjen e mjedisit*)

KONSUMIMI

■ ~0,31 kg/ m²/ shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
		set A+B=17 kg		
555071	e zezë	A=kovë 14,45 kg	650.25	kg
507818		B=bidon 2,55 kg	535.5	





NGARKESAT e shumta me të cilat ndërtesat rëndohen, legjislacionet më të rrepta, standardet që duhet të zbatohen dhe ndryshimet e shpeshta gjatë përdorimit të ndërtesave janë vetëm disa nga shembujt ku aplikimi i sistemeve të përforcimit statik sa vjen dhe bëhet i detyruar. Me pllakat Sika® CarboDur® apo pëlhurat SikaWrap® të gjitha këto kërkesa mund të plotësohen shpejtë, lehtë dhe me efikasitet.

SikaWrap®	88
SikaWrap® FX-50 C	89
SikaWrap® FX-75 G.....	89
Sikadur®-300	90
Sikadur®-330	90
Sika® CarboDur®	91
Sikadur®-30	91
Sika® CarboShear L	92
Sika MonoTop®-722 Mur E	93
SikaWrap®-350 G Grid	93


Referencë projekti



Përforcim strukturor
në QTU

SikaWrap®

Pëlhurë prej fibre karboni ose qelqi për përforcim strukturor



APLIKIMET

- Përforcim i konstruksioneve prej betonarmeje, mureve dhe elementeve strukturore prej druri për shtim të aftësisë bartëse përkulëse dhe prerëse
- Përmirësim i performancës sizmike të mureve
- Plotëson armaturën
- Përmirësim i rezistencës dhe duktilitetit të kolonave
- Shtim i aftësisë bartëse të elementeve strukturore
- Ndryshim të përdorimit të ndërtesave
- Korrigjim të defekteve të projektimit strukturor dhe/ ose të ndërtimit
- Shtim i rezistencës ndaj lëvizjeve sizmike
- Përmirësim i qëndrueshmërisë dhe jetëgjatësisë së funksionalitetit
- Përmirësim i strukturës në përputhje me rregulloret në fuqi

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Të prodhuara me fibra të thurura që pëlhura të ketë qëndrueshmëri (përpunim termik)
- Shumë lloje aplikimesh për çdo kërkesë përforcimi strukturor
- Modifikim i lehtë duke u përshtatur me gjeometrinë e strukturës (trarë, kolona, oxhaqe, shtylla, mure, silos)
- Disponohen në gjerësi të ndryshme për lehtësi gjatë aplikimit
- Dendësi e ulët për minimizimin e peshës shtesë
- Kosto më efikase krahasuar me teknikat tradicionale

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
613525	SikaWrap®-230C 600mm	rulon 50 m		900		m
413952	SikaWrap®-300C 300mm		2 rulona	2400		
413956	SikaWrap®-600C 300mm			1200	1 kuti	
413941	SikaWrap®-930G 600mm			1500	1 rulon	



Video aplikimi



SikaWrap®

SikaWrap® FX-50 C

Kordon fibrash karboni për lidhje, përforcim strukturor dhe ankorimin e sistemeve të përforcimit SikaWrap®



APLIKIMET

- Ankorim i pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® mbi beton ose mur
- Lidhje e pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® nëpërmjet strukturave prej betoni ose mureve
- Përforcim fleksibël i montuar pranë sipërfaqes (near surface mounted, NSM)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Fibër karboni, rezistuese ndaj korrodimit dhe e qëndrueshme
- Shumë përdorime
- Instalim i lehtë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
465764	i zi, 10 mm	rulon 25 m	800	1 rulon	m

SikaWrap® FX-75 G

Kordon fibrash qelqi për lidhje, përforcim strukturor dhe ankorimin e sistemeve të përforcimit SikaWrap®



APLIKIMET

- Ankorim i pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® mbi beton ose mur
- Lidhje e pëlhurave me fibra karboni ose qelqi SikaWrap® nëpërmjet strukturave prej betoni ose mureve
- Përforcim fleksibël i montuar pranë sipërfaqes (near surface mounted, NSM)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Fibër qelqi , rezistuese ndaj korrodimit
- Shumë përdorime
- Instalim i lehtë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
490518	fibër qelqi	rulon 25 m	800	1 rulon	m



Video aplikimi



SikaWrap® FX



Sikadur®-300

Rrëshirë epokside me 2 përbërës për impregnim



APLIKIMET

- Rrëshirë për impregnimin e pëlhurave të përforcimit strukturor SikaWrap® që aplikohen me metodën e lagësht
- Rrëshirë - prajmer për sistemin e lagësht të aplikimit

KONSUMIMI

- 0.4 - 1.0 kg/m²

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përzierje dhe aplikim i lehtë me rul për impregnim
- Prodhuar për metoda saturimi manuale ose mekanike
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënsh-tresa
- Vetë mekanike të mira
- Kohë tepër e gjatë punueshmërie

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
		set A+B=20kg		
472932	lëng ngjyrë e verdhë e lehtë	A = 14,88 kg	327,36	kg
472933		B = 5,12 kg	184,32	

Sikadur®-330

Rrëshirë epokside me 2 përbërës për impregnim



APLIKIMET

- Rrëshirë impregnimi për pëlhurën përforcuese SikaWrap® e aplikuar me metodën e thatë
- Rrëshirë prajmer për sistemin e aplikimit të thatë
- Ngjitës strukturor për ngjitjen e petëzave Sika® CarboDur® në prerjet

KONSUMIMI

- 0.7 - 1.5 kg/m²

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përzierje & aplikim i lehtë me mallë dhe rul
- Prodhuar për metoda manuale saturimi
- Sjellje e shkëlqyer aplikimi mbi sipërfaqe vertikale & horizontale
- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënsh-tresa
- Vetë mekanike të mira
- Nuk nevojitet prajmer

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
472851	gri e lehtë	set A+B=5 kg	360	kg



Sika® CarboDur®

Shirita fibrash karboni për përforcime strukturore



APLIKIMET

Përforcime strukturore për:

- Shtim kapaciteti për mbartje ngarkese
- Defekte në pjesë strukturore
- Përmirësim funksionaliteti
- Ndryshim i sistemit strukturor
- Ndryshim standardesh
- Defekte projektimi ose ndërtimi

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Nuk korrodohen, rezistencë shumë e lartë
- Qëndrueshmëri dhe rezistencë e shkëlqyer ndaj lodhjes
- Disponohen në gjatësi të mëdha
- Trashësi shumë e ulët, e cila lejon kryqëzime ose aplikime të njëpasnjëshme
- Transportohen lehtë, peshë e ulët, procedurë e lehtë aplikimi
- Përpunim paraprak minimal i shiritit
- Skaje të pastra, pa fibra të ekspozuara
- Disponohet shumë testime dhe miratime nga e gjithë bota

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
5712	S 512	rulon 250m	500		
456159	E 812	rulon 100m	800		
5714	S 1012	rulon 250m	500		
423916	S 1,030	rulon 250m		1 rulon	m

Sikadur®-30

Ngjitës epoksid tiksotropik për ngjitjen e përforcimeve




APLIKIMET

- Ngjitës për armaturën e jashtme përforcuese, veçanërisht në punimet e përforcimeve strukturore ku përfshihen:
- Shiritat Sika CarboDur® në beton, tulla, dru dhe shirita çeliku mbi beton

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përzierje dhe aplikim i lehtë, nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë e lartë ndaj zvarrjes në ngarkesë të përhershme
- Ngurtësimi nuk ndikohet nga lagështia e lartë
- Ngjitës i fuqishëm
- Tiksotropik: nuk varet në aplikime vertikale
- Fortësohet pa tkurrje
- Rezistencë mekanike fillestare & përfundimtare e lartë
- Rezistencë e lartë ndaj abrazionit & shokut
- I padepërtueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
452291	pastë, gri e lehtë	set A+B=6kg	432	kg



Video aplikimi



Sika CarboDur®

Sika® CarboShear L

Shirita fibrash karboni për përforcim strukturor (sistemi Sika® CarboDur® CFRP)



APLIKIMET

- Kapacitet i shtuar për bartje ngarkese
- Dëmtimet e elementeve të strukturës
- Përmirësim i shërbimit dhe qëndrueshmërisë
- Ndryshim i sistemit të strukturës
- Riparim i projektimit ose defekteve të ndërtimit

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Sistem i testuar ankorimi
- Jo korrodes
- Rezistencë dhe qëndrueshmëri shumë të larta
- Përforcues kundër grisjes dhe shpërthimit
- Ankorim preciz
- Peshë e lehtë
- Trashësi e përgjithshme e ulët, mund të mbivishet
- Transportim i lehtë
- Instalim i lehtë - pa pajisje instalimi
- Rezistence e shkëlqyer ndaj lodhjes
- Kërkohej përgatitje minimale e shiritave
- Ndikim estetik minimal

KODI	PËRSHKRIMI	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
52383	L 4/20/50	100	20 copë	copë
52385	L 4/30/70	50		
52386	L 4/50/100	100		

Sika MonoTop®-722 Mur E

Llaç me 1 përbërës për riparimin dhe përforcimin e mureve



APLIKIMET

- Riparime lokale të:
- Mureve (me tullat, blloqe, gurë)
- Në kombinim me SikaWrap-350 G Grid, përbën sistemin e duhur për përforcimin e mureve dhe lidhjen e elementeve prej betoni me muret.

KONSUMIMI

- ~ 1,50 kg/m²/mm trashësi shtrese

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Trashësi aplikimi 5-15mm
- Punueshmëri e shkëlqyer dhe finiturë e lëmuar
- Ngjitje shumë e mirë mbi nënshtresat tullat, gurë, beton
- Modul i ulët elasticiteti
- Për riparime lokale jostrukurore të elementeve prej betoni
- Qëndrueshmëri e mirë përmasash, nuk varet në aplikimet tavanore
- Finirimi i sipërfaqes është i mundur me sfungjer ose shpatull metalike

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
559190	pluhur gri	thes 25 kg	50	copë

SikaWrap®-350 G Grid

Rrjetë fibrash qelqi me veshje rezistente ndaj alkaleve për llaçet që përforcohen me pëlhurë




APLIKIMET

- Përforcimin e mureve prej tullash, blloqesh ose guri
- Përforcimin e mbushjeve të mureve
- Lidhjen e mureve me mure të tjera ose me struktura betonarmeje
- Shtimin e rezistencës ndaj dështimit jashtë planit të mureve
- Shtimin e rezistencës dhe duktilitetit në plan të mureve
- Riparimin e mureve me plasaritje

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Rezistencë e lartë ndaj tërheqjes në të dyja drejtimet
- Ekonomik
- Nuk korrodon
- Veshje rezistente ndaj alkaleve



KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
182303	gri, 1x50m	rulon 50 m²	500	m²



Video aplikimi



Sika CarboShear®



Video aplikimi



Sistemi Sika TRM



Fiksime, mbushje, ankorime

LLAÇET që aplikohen me derdhje janë të rrjedhshëm, kanë rezistencë të lartë, bazë poliuretani ose epokside, dhe përdoren për mbushje të hapësirave në vende ku do të montohen makineri, si dhe për mbushje ose ankorime në elemente strukturore. Sika ofron produkte të të gjitha teknologjive, për ngjitje joelastike, për ankorime me mpiksje të shpejtë, performancë dhe kërkesa të larta, edhe për aplikime specifike si ankorimet elastike të shinave të trenit.

SikaGrout®-212 Classic	96
SikaGrout®-312 HP	97
SikaGrout® HT System	98
Sika AnchorFix®-1	99
Sika AnchorFix®-2+	100
Sika AnchorFix®-3030	101
Sikadur®-31 EF	102
Sikadur®-32 EF	102
Sikadur®-42 SP	103
Sikadur®-52 Injection Normal & LP	103

Skano për të zbuluar më shumë rreth aplikimeve të mëposhtme:



Graute



Ankorime



Ngjitje e ngurtë

SikaGrout®-212 Classic

Graut çimentoje me 1 përbërës që aplikohet me derdhje për mbushje, ankorime dhe riparim betoni



APLIKIMET

- Për trashësi aplikimi midis 5-30mm
- Ankorime bulonash (ankorazh etj.) dhe struktura metali për vendosjen e pllakave metalike që shërbejnë si bazament makinerie, makineri, themele shtyllash, etj.
- Mbushje me derdhje të thjeshtë (ose pompim) të kaviteve, plasaritjeve, hapësirave, vrimave dhe porozitetit në beton, mure, shkëmbinj, etj.
- Grauting midis themeleve dhe bazave për suportin e pajisjeve dhe makinerive
- Restaurim betoni duke riderdhur llaç në kallëpe (trarë, kolona, kuverta urash)
- Fiksime të mëvonshme






KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, pluhur gati për përzierje; thjesht shtoni ujë (dhe agregate nëse dëshironi)
- Kompensim i tkurrjes për shkak të përhapjes
- Rrjedhshmëri e madhe pa segregim apo rrjedhje
- Rezistenca mekanike të larta dhe ndërkapje shumë e mirë mbi beton dhe çelik
- Aplikim me derdhje dhe/ose pompë
- Për trashësi aplikimi më të mëdha, referohuni tek sistemi SikaGrout® HT System

KONSUMIMI

- ~ 2,0 kg pluhur / mm trashësi / m²

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
500192	pluhur gri	thes 25 kg	48	copë



SikaGrout®-312 HP

Llaç inxhinierik me performancë të lartë dhe bazë çimentoje, i përforcuar me fibra që aplikohet me derdhje (SCC), për riparime dhe ankorime



APLIKIMET

- Trashësi aplikimi 10-50 mm
- Mbushje precize ndërmjet themeleve dhe suporteve, poshtë pllakave të bazamenteve, izoluesve sizmikë ose makinerive dhe pajisjeve të rënda
- Ankorime bulonash (ankorazhe, vida, etj.) dhe strukturash metalike
- Restaurim elementesh betoni duke rihedhur llaç brenda kallëpeve
- Mbushje me derdhje të thjeshtë (ose pompim) të hapësirave, plasaritjeve dhe porozitetit në beton, mure, gurë, etj.
- Izolim përreth depërtimeve

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, pluhur gati për përzierje; thjesht shtoni ujë (dhe agregate nëse dëshironi)
- Kompensim i tkurrjes
- Rrjedhshmëri e madhe pa segregim apo rrjedhje
- Rezistenca mekanike të larta dhe ndërkapje shumë e mirë mbi beton dhe çelik
- Aplikim me derdhje dhe/ose pompë
- Për trashësi aplikimi më të mëdha, referohuni tek sistemi SikaGrout® HT System

KONSUMIMI

- ~ 2,0 kg pluhur / mm trashësi / m²

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
525433	pluhur gri	thes 25 kg	48	copë



SikaGrout® HT System

Sistem me bazë çimentoje që aplikohet me derdhje për aplikime në shtresa të mëdha



APLIKIMET

- SikaGrout® HT System-80: trashësi shtrese midis 15-80 mm.
- SikaGrout® HT System-120: trashësi shtrese midis 20-120 mm.
- Grauting preciz midis themeleve dhe suroteve, poshtë pllakave të bazamenteve, izoluesve sizmikë apo makinerive të rënda dhe pajisjeve
- Ankorime si bulona (ankorazhe, vida, etj.) dhe struktura metalike për blloqet e pllakave mbështetëse, makineri, shtylla themelesh
- Mbushje me derdhje të thjeshtë (ose pompim) i zgavrave, plasaritjeve dhe hapësirave në beton, mure, shkëmbinj, etj.
- Izolime përreth depërtimeve (p.sh. tubacione)
- Fiksime





KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, gati për përzierje, thjesht shtoni ujë
- Kompensim i jashtëzakonshëm i tkurrjes (në fazë plastike dhe të ngurtësuar)
- Vetë të shkëlqyera rrjedhjeje, punueshmërie dhe qëndrueshmërie
- Pa segregim dhe rrjedhje
- Rezistenca mekanike të larta dhe ngjitje e shkëlqyer mbi beton dhe çelik
- Mund të derdhet dhe/ose pompohet
- Klasifikimi i zjarrit A1

KONSUMIMI

- ~ 2,0 kg pluhur / mm trashësi / m²

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
	SikaGrout® HT-80	31,25 kg		copë
500192	Sikagrout®-212 Classic, gri	thes 25 kg	48	
519421	Sikagrout® Quartz Sand 3-6mm	qese 6,25 kg	160	
	SikaGrout® HT-120	31,25 kg		
525433	Sikagrout®-312 HP	thes 25 kg	48	
519421	Sikagrout® Quartz Sand 3-6mm	qese 6,25 kg	160	



Sika AnchorFix®-1

Ngjitës ankorimi me tharje të shpejtë



APLIKIMET

- Ngjitës ankorimi me tharje të shpejtë për:
- Shufra / çelik për armaturë
 - Shufra të filetuara
 - Bulona dhe sisteme të posaçme mbërthimi
 - Beton
 - Mure zgavër dhe solide
 - Gur natyror i fortë

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Tharje e shpejtë
- Mund të përdoret pistoletë standarde
- Mund të përdoret në temperatura të ulëta
- Kapacitet i lartë për bartje ngarkese
- Disponohet miratimi ETA
- Nuk rrjedh, edhe në aplikime tavanore
- Pa stiren
- Arome e lehtë
- Sasi e pakët firoje

KONSUMIMI

- Konsumimi varet nga përmasat e birës së shpuar

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
497952	gri e hapur	tubetë 300 ml	12	900	1 kuti	copë

Sika AnchorFix®-2+

Ngjitës ankorimi për ngarkesa mesatare deri të larta



APLIKIMET

- Ngjitës ankorimi me tharje të shpejtë për:
- Shufra / çelik për përforcim
 - Shufra të filetuara
 - Bulona dhe sisteme të posaçme mbërthimi
 - Beton (te plasaritur ose jo)
 - Mure solide
 - Çelik
 - Gur natyror i fortë
 - Gur solid


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Tharje e shpejtë
- Mund të përdoren pistoletat standarde
- Kapacitet i lartë për mbartje ngarkese
- I përshtatshëm për betonin e plasaritur
- Certifikuar për ujin e pijshëm
- Disponohet certifikate LEED
- Nuk varet, edhe në aplikime tavanore
- Pa stiren
- Me pak aromë
- Firo e ulët

KONSUMIMI

- Konsumimi varet nga përmasat e birës së shpuar

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
594183	gri	tubetë 300 ml	12	900	1 kuti	copë



Sika AnchorFix®-3030

Ngjitës epoksid për ankorim kimik me performancë të lartë



APLIKIMET

Ngjitës ankorimi për fiksimin e ankorazheve jo të zgjerueshme si:

Punime strukturore

- Ankorim shufrash përforcimi në punime të reja ose rikonstruksione
- Shufra të filetuara
- Bulona dhe sisteme të posaçme fiksimi/ mbërthimi

Punime metali, druri

- Parmaqe, balustrada dhe mbështetëse
- Kangjella
- Kasa dyersh dhe dritaresh

Nënshtresat

- Beton (te plasaritur ose jo)
- Mure solide
- Çelik
- Gur natyror ose artificial
- Gur solid


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Kohë e gjatë punueshmërie
- Mund të përdoret mbi beton të lagësht
- Kapacitet i lartë ngarkese
- Testim sizmik (C1 & C2)
- I përshtatshëm për kontaktin me ujin e pijshëm
- Rezistencë ndaj zjarrit
- Pa stiren
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresë
- Ngurtësim pa tkurrje
- Çlirime të ulëta
- Firo e pakët

KONSUMIMI

- Konsumimi varet nga përmasat e birës së shpuar

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
580346	gri	tubetë 385 ml	12	840	1 kuti	copë





Sikadur®-31 EF

Ngjitës strukturor epoksid me 2 përbërës



APLIKIMET

- Ngjitës strukturor për: elemente betoni, gur natyror i fortë, qeramika, çimento me fibra, llaç, tulla, mur, dru, poliester, epoksid
- Riparim dhe ngjitje për: kënde dhe skaje, vrima dhe zgavra
- Mbushje, riparime fugash dhe izolim plasaritjesh
- Aplikim vertikal dhe horizontal
- Përdorim i brendshëm dhe i jashtëm

KONSUMIMI

- ~ 1,95 kg/m²/mm trashësie

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Temperaturë aplikimi nga +10 °C deri në +30 °C
- Përzjerje dhe aplikim i lehtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumicën e materialeve të ndërtimit
- Tiksotropik: nuk varet në aplikime vertikale dhe horizontale
- Ngurtësim pa tkurje
- Nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë ndaj abrazionit
- I papërshkueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit
- Rezistencë kimike

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
534999	gri	set A+B=1,2 kg	8	320	1 kuti	set
536985		set A+B=6 kg		432		kg

Sikadur®-32 EF

Agjent epoksid me 2 përbërës për ngjitje strukturore



APLIKIMET

- Elemente betoni (përfshirë ngjitjen e betonit të freskët me betonin e ngurtësuar)
- Gur i fortë natyror
- Qeramika, çimento me fibra
- Llaç, tulla, mure
- Çelik, hekur, alumin, dru, qelq
- Poliester/fibra qelqi dhe materiale rrëshire epokside




KONSUMIMI

- ~ 1,3 kg/m²/mm trashësie

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përzjerje dhe aplikim i thjeshtë
- Ndërkapje e mirë mbi shumë materiale ndërtimi
- Ngurtësohet pa tkurje
- Nuk nevojitet prajmer
- Rezistencë e lartë mekanike fillestare & përfundimtare
- I papërshkueshëm nga lëngjet dhe avujt e ujit
- Rezistencë kimike e mirë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
545534	gri	set A+B=1 kg	8	320	1 kuti	set
545555		set A+B=4,5 kg		432		kg



Sikadur®-42 SP

Llaç i vetënivelueshëm rrëshire epokside me 3 përbërës që aplikohet me derdhje



APLIKIMET

- Fiksim ankorazhesh mbi sipërfaqe horizontale
- Ankorim armature mbi sipërfaqe vertikale betoni gjatë aplikimeve strukturore
- Derdhje precize poshtë pllakave mbështetëse të urave ose makinerive
- Mbushje e plasaritjeve dhe vrimave të mëdha në beton

KONSUMIMI

- 1.9 kg / litër miksi

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Ngjitje shumë e mirë mbi shumicën e materialeve të ndërtimit: beton, llaç, gurë, çelik, qelq, rrëshira poliesteri ose epokside
- Pa tretës
- Përzjerje e lehtë, rrjedhje dhe vendosje e mirë
- Ngurtësohet shpejtë pa tkurje
- Lagështia nuk ndikon ngurtësimin

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
92330	gri	set A+B+C=1,5 kg	8 sete	320	1 kuti	kg
93843		set A+B+C=5 kg		480		

Sikadur®-52 Injection Normal & LP

Rrëshirë epokside me viskozitet të ulët për injektim - kohë punueshmërie normale



APLIKIMET

- Mbush dhe izolon hapësirat dhe plasaritjet në struktura si: urat, struktura të inxhinierisë së ndërtimit, ndërtesa industriale dhe banimi, p.sh. kolona, trarë, themele, mure, dyshe dhe struktura ujëmbajtëse
- Ngjitje strukturore
- Parandalim i hyrjes së ujit dhe infiltrimit të substancave që ndikojnë në ndryshkjen e armaturës

KONSUMIMI

- 1 kg rrëshirë injektimi: ~0,93 L


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Temperaturë injektimi +5°C deri +30°C
- Ngjitje e mirë mbi beton, mure, gurë, çelik dhe dru
- I përshtatshëm për kushte të thata dhe të lagështa
- Gjerësi max. plasaritjeje 5,0 mm
- Rezistenca mekanike të larta
- I fortë, por jo i thyeshëm
- Viskozitet i ulët, injektohet me pompë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
517958	e verdhë/kafe LP	set A+B=1 kg	8 sete	320	1 kuti	set
487237	e verdhë/kafe N					



Zbulo më shumë



Sisteme për shtrim
dysHEMEJE

Shtrim dysHEMEJE

MJEDISET bashkëkohore industriale, tregtare dhe magazinat, zonat e qarkullimit të produkteve, mjediset e prodhimit dhe përpunimit, zonat me shkallë të lartë higjienë etj. bëjnë të domosdoshëm krijimin e dysHEMEVE me derdhje që u përgjigjen sforcimeve të rënda mekanike, kimike dhe termike, duke plotësuar në të njëjtën kohë nevojat për rezistencë ndaj rrëshqitjes, higjienë dhe estetikë të lartë. Zgjidhjet me sistemet Sikafloor® ofrojnë mundësinë e përzgjedhjes midis një shumëllojshmërie ngjyrash. Mund të aplikohen në trashësi të ndryshme për të përfutur sipërfaqe përfundimtare me pamje të bukur. Zhvillojmë sisteme, duke patur parasysh jetëgjatësinë e konstrukcionit, nevojat funksionale, fugat ndërtimore, lidhjet dysHEME-mur, projektimin përfundimtar të sipërfaqes dhe detajet e aplikimit.

Sikafloor®-3 QuartzTop	106
Sika® Patch-5 Rapid	106
Sikafloor® ProSeal-22	107
Sikafloor® ProSeal W	107
Purigo®-I 100	108
Sikafloor®-01 Primer	108
Sikafloor® Level-30	109
Sikafloor®-100 Level	110
Sikafloor®-200 Level	110
Sikafloor®-300 Level	111
Sikafloor®-81 EpoCem	112
SikaTop®-10	113
SikaDecor®-801 Nature.....	114
SikaDecor®-803 Plus	114
SikaDecor® Color.....	115
Sikafloor®-150	116
Sikafloor®-151	116
Sikafloor®-155 WN	117
Sikafloor®-2540 W	118
Sikafloor®-264 N	119
Sikafloor®-2640	120
Sikafloor®-263 SL N.....	121
Sikafloor®-3240	122
Sikafloor®-400 N Elastic/Elastic+	123
Sikafloor®-410	123

Sikafloor®-3 QuartzTop

Forcues me ngjyrë dhe me bazë minerale për dysheme betoni



APLIKIMET

- Kontribuon në formimin e dyshemeve monolitike prej betoni, rezistuese ndaj konsumimit. Kur spërkatet dhe inkoorporohet në dyshemetë prej betoni të freskët, formon një sipërfaqe të lëmuar dhe rezistente ndaj konsumimit.
- Përdorime tipike në magazina, fabrika, qendra tregtare, kudo që dyshemeja me rezistencë ndaj konsumimit dhe abrazionit është kërkesa kryesore.

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj përplasjeve
- Forcues i sipërfaqes me kosto efikase
- Kundër pluhurit
- Aplikim i shpejtë
- Rezistencë e shtuar ndaj vajrave dhe grasos
- Përzierje e përbërësve në fabrikë, me cilësi të garantuar të produktit përfundimtar
- Pastrim i lehtë i sipërfaqes përfundimtare
- Shumëllojshmëri ngjyrash

KONSUMIMI

- ~4- 5 kg/m²

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
500157	pluhur gri	thes 25 kg	48	copë

Sika® Patch-5 Rapid

Llaç me bazë çimentoje, 1 përbërës dhe me ngurtësim të shpejtë që aplikohet me derdhje për riparime lokale mbi dysheme dhe beton



APLIKIMET

- Restaurim betoni me derdhje llaçi brenda betoformave (trarë, kolona, kuverta urash).
- Riparime lokale/ rikonstruksion i dyshemeve industriale në mjedise të brendshme dhe të jashtme prej betoni ose me bazë çimentoje, fuga rrugësh, puseta dhe aty ku kërkohet tharje e shpejtë dhe rezistencë e lartë ndaj abrazionit ose aty ku ndërprerja e shërbimit duhet të pakësohet.


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përdorim i lehtë, thjesht shtoni ujë
- Mpiksje dhe ngurtësim i shpejtë
- I vetëkompaktueshëm, rrjedhje, punueshmëri dhe stabilitet të mira
- Rezistencë ndaj abrazionit / konsumimit
- Pa segregim ose rrjedhje
- Trashësi aplikimi 15-50 mm/ shtresë, pa agregate
- Trashësi aplikimi deri në 100 mm me rërë kuarci 6-12 mm

KONSUMIMI

- ~ 2.0 kg pluhur për 1 lt miks

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
558425	pluhur gri	thes 25 kg	48	copë



Sikafloor® ProSeal-22

Përbërës për tharjes dhe izolimin e dyshemeve prej betoni



APLIKIMET

- Dysheme dhe struktura
- Përbërës për tharjen për të kufizuar thatësinë dhe plasaritjen e sipërfaqes
- Ofron tharje dhe izolim për forcuesit e sipërfaqeve Sikafloor®, trajtim kundër mbledhjes së pluhurit dhe përmirësim të rezistencës kundër abrazionit të sipërfaqeve ekzistuese prej betoni
- I përshtatshëm për aplikim të brendshëm dhe të jashtëm

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Mbajtje e shkëlqyer e lagështisë
- Ndhmon në kontrollin e mbledhjes së pluhurit
- Than dhe izolon me efikasitet sipërfaqet e betonit, me një veprim të vetëm dhe ekonomik
- Rezistencë e mirë ndaj abrazionit
- Tharje e shpejtë
- Ndërkapje e mirë mbi betonin e ri dhe të vjetër
- Aplikim i lehtë me spërkatje ose rul

KONSUMIMI

- 0.1-0.2 l/m²/shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
78158	lëng	kovë 25 lt	450	lt
85212	transparent	fuçi 200 lt	400	

Sikafloor® ProSeal W

Përbërës me bazë uji për tharjen dhe izolimin e dyshemeve prej betoni



APLIKIMET

- Përbërës për tharje në mënyrë që të kufizohet plasaritja sipërfaqësore
- Ofron tharje dhe izolim pas aplikimit të forcuesve të sipërfaqes së dyshemeve nga seria Sikafloor®
- Trajtim kundër pluhurit dhe për përmirësimin e rezistencës ndaj abrazionit të sipërfaqeve ekzistuese prej betoni
- I përshtatshëm për aplikime të brendshme dhe të jashtme

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Me bazë uji
- I përshtatshëm për përdorim të brendshëm ku produktet me bazë tretësi nuk mund të aplikohen për shkak të rregulloreve për shëndetin dhe sigurinë
- Ndhmon në kontrollin e pluhurosjes për sipërfaqet e dyshemeve prej betoni të reja dhe ekzistuese
- Thahet dhe izolon me efikasitet sipërfaqet prej betoni në një veprim të vetëm dhe ekonomik
- Zverdhje shumë e ulët
- Aplikim i lehtë me spërkatje ose rul

KONSUMIMI

- 0.1-0.2 l/m²/shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
83637	lëng	bidon 5 lt	450	lt
85210	transparent	fuçi 200 lt	400	

Purigo®-I 100

Stabilizues i sipërfaqes me efekt kundër pluhurit për dyshemetë prej betoni



APLIKIMET

- Përmirësim i rezistencës së sipërfaqes prej betoni
- Në mjedise të brendshme dhe të jashtme
- Redukton absorbueshmërinë e betonit
- Për aplikime në papafingo, garazhe, magazina, bazamente, nënshtresa për dysheme lundruese (poshtë pllakave)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Kundër pluhurit
- Përthithje e reduktuar e vajrave dhe lëngjeve të tjera
- Rezistencë e përmirësuar ndaj konsumimit
- Pastrim i lehtë
- Produkt pa ngjyrë dhe pa erë

KONSUMIMI

- ~ 0.15-0.25 kg/m²/shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
5031	emulsion i bardhë	bidon 5 kg	540	kg

Sikafloor®-01 Primer

Prajmer me bazë uji për dyshemetë, përdoret për përbërësit e nivelimit dhe kollat e pllakave



APLIKIMET

- Reduktimin e absorbueshmërisë së nënshtresës
- Përmirësim i ndërkapjes me nënshtresat e lëmuara dhe të qëndrueshme
- Mbrojtje e nënshtresës ndaj lagështisë nga përbërësit e nivelimit me bazë çimentoje ose kollat e pllakave

KONSUMIMI

- ~70 g/m²

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Konsumim i ulët / mbulim i madh
- I përshtatshëm për aplikime tek sistemet e ngrohjes nëndysheme
- Redukton formimin e pluhurit
- Kompatibilitet me nënshtresat e përcaktuara
- Çlirime shumë të ulëta
- Aplikim me furçë, rul ose spërkatje
- Mund të hollohet me ujë
- Gati për përdorim
- Pa tretës

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
547522	lëng, blu	bidon 5 kg	450	kg
498421		bidon 10 kg	600	



Sikafloor® Level-30

Llaç çimentoje me performancë të lartë për dyshemetë, i vetënivelueshëm dhe me tharje të shpejtë për mjedise të brendshme e të jashtme në trashësi 4-30 mm



APLIKIMET

- Llaç dyshemeje i vetënivelueshëm për nivelim ose lëmim të llaçeve të dyshemeve në trashësi midis 4-30mm
- Llaç dyshemeje për kushte shërbimi industrial kur izolohet me veshje përfundimtare rrëshire PU ose EP për ngarkesë mesatare në të lartë (qarkullim i rëndë + pirunash me ngarkesë tronditëse).
- Për mbushje, lëmim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara aplikimit të parketeve, pllakave qeramike, dyshemeje prej rrëshirë pa bashkime, tekstileve, mbulesave elastike të dyshemeve.
- Përdoret si llaç dyshemeje në mjedise të jashtme kur izolohet me një mbulim, p.sh.veshje.


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm dhe shumë fluid
- Aplikim i lehtë manual ose me pompë
- Gati për përdorim
- Tkurrje e ulët
- Punueshmëri të mirë
- Mpiksje dhe tharje e shpejtë
- Mundësi për qarkullim me ecje pas 3-4 orësh (+20°C)
- Paraqitje dhe fortësi sipërfaqjeje e mirë
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj ngrirjes-shkrirjes (R3)
- Pa kazeinë dhe formaldehide
- I përshtatshëm për përdorim me sistemet e ngrohjes nën dysheme

KONSUMIMI

- ~1.8 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
162680	pluhur bezhë-gri	thes 25 kg	1000	kg



Sikafloor®-100 Level

Përbërës me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere për nivelim dyshemeje në 2-10 mm



APLIKIMET

■ I përshtatshëm për mbushje, lëmim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara shtrimit të pllakave qeramike, veshjeve tekstile dhe elastike (vinili, linoleumi) për dyshemetë e zonave të brendshme rezidenciale dhe joindustriale

KONSUMIMI

■ ~ 1.5 kg/m²/mm

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- I papërshkueshëm nga ngjitësit me bazë uji
- I vetënivelueshëm
- Finiturë e lëmuar
- I përshtatshëm për aplikim me sistemet e ngrohjes nën dysheme
- I pompueshëm
- I përshtatshëm për karriget me rrota të zyrave me trashësi shtrese më të madhe se 2mm
- I modifikuar me polimere
- Transmetim i ulët tensioni tek nënshtresa

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
496771	pluhur gri	thes 25 kg	1050	kg

Sikafloor®-200 Level

Llaç i vetënivelueshëm çimentoje dhe i modifikuar me polimere për trashësi aplikimi 3-40 mm



APLIKIMET

Nivelim i nëndyshemeve rezidenciale dhe joindustriale në mjedise të brendshme dhe të jashtme përpara aplikimit:

- Dysheme druri
- Dysheme parketi
- Pllaka qeramike
- Pllaka guri
- Dysheme rrëshire pa bashkime
- Veshje tekstile për dyshemetë
- Veshje elastike për dyshemetë (linoleum, vinyl)

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm
- Trashësi shtrese: 3-40 mm. 60 mm me agregate
- I papërshkueshëm nga ngjitësat me bazë uji
- I përshtatshëm për aplikim mbi sistemet e ngrohjes nën dysheme
- Sforcim shumë i ulët mbi nënshtresë
- I pompueshëm
- I përshtatshëm për karriget me rrota të zyrave në përputhje me EN 12529
- I përshtatshëm si nënshtresë për ngjitjen e pllakave qeramike, i aplikuar mbi nënshtresa çimentoje

KONSUMIMI

■ ~ 1.8 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
496772	pluhur gri	thes 25 kg	1050	kg

Sikafloor®-300 Level

Përbërës me bazë çimentoje dhe i modifikuar me polimere për nivelim dyshemeje në 1-10 mm



APLIKIMET

■ Për mbushje, lëmim dhe nivelim të nënshtresave të përshtatshme përpara aplikimit të parketit, pllakave qeramike, dyshemeve prej rrëshire pa fuga, mbulimeve tekstile elastike të dyshemeve për mjedise të brendshme në zona rezidenciale dhe joindustriale.

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- I vetënivelueshëm
- Për aplikime në sistemet me ngrohje nën dysheme
- Trashësi shtrese deri në 20 mm me agregate
- I përshtatshëm për ngarkesën e karrigeve me rrota të zyrave në trashësi shtrese > 1 mm
- I pompueshëm
- Nivel i lartë fortësie dhe rezistence
- Porozitet i ulët i sipërfaqes, finiturë shumë e lëmuar
- I modifikuar me polimere
- Tharje nëpërmjet hidratimit
- Nivelim i parregullsive të sipërfaqes
- Transmetim i ulët tensioni tek nënshtresa

KONSUMIMI

■ ~ 1.5 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
496773	pluhur gri	thes 25 kg	1050	kg

Sikafloor®-81 EpoCem

Llaç çimentoje i modifikuar me epoksid, me 3 përbërës dhe i vetënivelueshëm për shtresa dyshemeje 1,5-3 mm



APLIKIMET

- Si barrierë e përkohshme kundër lagështisë poshtë dyshemeve prej rrëshire, PUR dhe PMMA
- Nivelim ose riparim lokal i sipërfaqeve horizontale prej betoni, gjatë punimeve të reja ose riparimeve, në mjedise agresive kimike
- Veshje dyshemeje mbi nënshtresa të lagështa dhe pa ajrosje që nuk kanë kërkesa estetike të veçanta
- Shtresë niveluese poshtë dyshemeve / llaçeve epokside, PUR, PMMA*, pllakave, moketave ose dyshemeve prej druri
- Riparim dhe mirëmbajtje e dyshemeve monolite (njëcopëshe) prej betoni
- Me shtim rëre kuarci, si llaç për riparime lokale


KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Mundësi mbiveshjeje me dysheme me bazë rrëshire pas 24 orësh
- Aplikim ekonomik, i shpejtë dhe i lehtë
- Vetë të mira nivelimi
- I papërshkueshëm nga lëngjet, por i përshkueshëm nga avujt e ujit
- Rezistencë ndaj ngricës dhe kripës për shkrirje akulli
- Rezistencë kimike e mirë
- Vetë zgjerimi termik të ngjashme me betonin
- Ngjitje e shkëlqyer mbi beton i cili sapo ka fituar rezistencat ose të ngurtësuar, i lagësht ose i thatë
- Rezistenca të shkëlqyera mekanike fillestare dhe përfundimtare
- Rezistencë e shkëlqyer ndaj ujit dhe vajrave
- Përgatitje ideale për sipërfaqe të lëmuar
- Për përdorim të brendshëm, pa tretës
- Nuk korrodon armaturën prej çeliku

KONSUMIMI

- ~2.25 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
	gri e lehtë	set A+B+C=23 kg		kg
418482	lëng i bardhë	A=shishe 1,14 kg	369,36	
92377	lëng i verdhë i tejdukshëm	B=bidon 2,86 kg	308,88	
92378	pluhur gri	C=thes 19 kg	1026	



SikaTop®-10

Prajmer me bazë uji për nënshtresa çimentoje



APLIKIMET

- Posaçërisht për përdorim si prajmer për SikaDecor®-803 Nature
- Mbi nënshtresa minerale, veshje çimentoje dhe pllaka të vjetra qeramike
- Nuk është i përshtatshëm për sipërfaqet vertikale



KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Ndërkapje e shkëlqyer mbi nënshtresa poroze dhe qelqi
- Parandalon humbjen e ujit tek nënshtresa
- Ekonomik
- Shton rezistencën
- Rezistencë ndaj pH alkalin
- Gati për përdorim
- Përdorim i lehtë
- Për nënshtresa me përmbytje më të lartë lagështie

KONSUMIMI

- ~ 0.2 - 0.5 kg/m²/shtresë

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
441145	lëng i kuq	kovë 5 kg	480	kg



SikaDecor®-801 Nature

Mikroçimento dekorative dhe me ngjyrë për aplikime të brendshme



APLIKIMET

- Veshje dekorative dhe të njëtrajtshme mbi dysheme dhe mure në mjedise të brendshme
- I përshtatshëm për nënshtresa me bazë çimentoje ose gipsi
- Për dhoma, zyra, papafingo, etj.
- Mund të jetë i përshtatshëm për veshje dekorative në dyqane, shtëpi private, ndërtesa publike me konsumim të lehtë të sipërfaqes

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Dozë paraprake
- Rezistencë e mirë ndaj rrezatimit UV
- Punueshmëri e shkëlqyer
- Ndërkapje e mirë mbi nënshtresë
- Aplikim i shpejtë
- Tepër dekorativ dhe estetik, ofron një sipërfaqe unike
- I transpirueshëm

KONSUMIMI

- ~ 1.75 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
466576	i bardhë	kovë A+B=13 kg	312	kg



SikaDecor®-803 Plus

Shtresë niveluese për sistemin e llaçit dekorativ me bazë çimentoje SikaDecor®



APLIKIMET

- Rregullim dhe riprofilizim përpara aplikimit të mikroçimentos SikaDecor®-801 Nature mbi:
- Llaçe me bazë çimentoje
 - Tulla
 - Sipërfaqe të shtruara me pllaka, etj

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Përbërës të gatshëm, përzjerje e lehtë
- Aplikim i thjeshtë
- Tkurrje e ulët
- Llaç për aplikim të përgjithshëm

KONSUMIMI

- ~ 2.0 kg/m²/mm


KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
		set A+B = 30 kg		kg
467928	lëng	A = bidon 5 kg	540	
558424	pluhur i bardhë	B = thes 25 kg	50	



SikaDecor® Color

Pigment i lëngshëm për sistemin SikaDecor®

Lista e ngjyrave



SikaDecor®

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	KUTIA	PALETA	POROSIA MIN.	NJËSIA
554985	1 Silber/Plata/Silver	shishe 0,5 lt	6	768	1 copë	copë
554984	2 Perle/Perla/Pearl					
554795	3 Arena/Albero					
554983	4 White/Weiss					
554924	5 Altweiss/Bone/Hueso					
554987	6 Ivory/Marfil/Eflenbein					
554990	7 nickel/niquel					
554989	8 Rhodium/Rodio					
554982	9 Schmiede/Forja					
554991	10 grey marengo					
554988	11 steel/stahl					
	12 Nacar/Nacre					
554925	13 sand					
568318	14 land					
468305	15 Bahía					
	16 Trigo/Wheat					
568319	17 vanilla					
468346	18 clay					
468429	19 Barro/Mud					
468307	20 tile/ziegel					
468337	21 Terracota					
468350	22 Antarctica/ Antarktis					
468308	23 Ocean/Ozean					
468352	24 marine					
468338	25 Adriático/Adriatic					
468309	26 turquoise					
468335	27 jade					
468314	28 Emerald/Esmeralda					
468315	29 Moss/Moos/Musgo					
	30 Helecho/Fern					
468317	31 Trebol/Clover					
468336	32 lime/limette					
468341	33 lemon/zitrone					
468342	34 Melocotón/Peach					
468318	35 mandarine/Tangerine					
554926	36 Strawberry/Madrono					
468343	37 chocolate/Schoko					
554986	38 Shabby chic rosa					
468353	39 mallow/malve					
468348	40 Levendel/Levanda					
468345	41 sandalwood/sandale					

Sikafloor®-150

(Ky produkt zëvendëson produktin e mëparshëm Sikafloor®-156)

Prajmer epoksid, llaç nivelues dhe llaç për shtrime



APLIKIMET

- Prajmer për nënshtresa betoni, llaçe çimentoje për shtrim dhe llaçe epokside
- Për nënshtresa me absorbueshmëri normale në të madhe
- Kontroll lagështie mbi nënshtresat me bazë çimentoje me përmbajtje lagështie ≤ 4 % CM (99 % RH)
- Prajmer për dyshemetë Sika epokside dhe PUR
- Binder për llaçet e nivelimit dhe shtrimit

KARAKTERISTIKA & AVANTAZHE

- Viskozitet i ulët
- Më pak erë
- Depërtim i mirë
- Rezistencë e mirë ngjitjeje
- Aplikim i lehtë
- Kohë e shkurtër pritjeje
- Shumë-përdorimesh

KONSUMIMI

- Si prajmer: 0,3-0,5 kg/m²
- Si llaç nivelues: 1,4-2,2 kg/m²/mm

KODI	PËRSHKRIMI	AMBALAZHI	PALETA	NJËSIA
601603		kovë A+B=10 kg	300	kg
		kovë A+B=25 kg		
579477	transparent	A=kovë 18,5 kg	388,5	
579473	lëng kafe	B=kovë 6,5 kg	390	

Sikafloor®-151

(Ky produkt zëvendëson produktin e mëparshëm Sikafloor®-161)

Prajmer epoksid, llaç nivelues, shtresë e ndërmjetme dhe llaç për shtrime



APLIKIMET

- Prajmer për nënshtresa betoni, llaçeve të çimentos dhe llaçeve epokside
